

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                                                                                         |
|---------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Irani synon të kontrollojë kontaktet me të huajt, projektligji për “infiltrimin” nxjerr në pah përçarjet brenda establishmentit                                                                                                                         |
| ADRESA  | <a href="https://www.gazetatema.net/bota/irani-synon-te-kontrolloje-kontaktet-me-te-huajt-projekt-ligji-per-infiltrim-i585320">https://www.gazetatema.net/bota/irani-synon-te-kontrolloje-kontaktet-me-te-huajt-projekt-ligji-per-infiltrim-i585320</a> |
| BURIMI  | gazetatema.net                                                                                                                                                                                                                                          |
| GJENDJA | edited                                                                                                                                                                                                                                                  |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 11 shtator 2026, 07:37:43 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 11 shtator 2026, 07:35:00 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | b8afcb9ffe6abc7949aeb3ec178d20c331138831ff33ab2baa75186ed43cdd33 |
| TEKSTI     | 1b14e6b8dbdd586bb7734090ea3e2acdafd83ec583b205bfdd35538336a71fe2 |
| PAMJA      | 31d9827c7e2bb8777f2610d479b7b2bed3e6f191dfd6d19fd8e0a339b8ae055c |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                                                                                    |
|---------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | 47041f9d0824f697beb624f835c04da2fcea62d22f9833cc4c3f10e9bbad454a                                                                                                   |
| E MËPARSHMJA  | d85a2fcb95328da6d3092c30e670d4c1a7cb1f14eb011193fe5512a9b789883a                                                                                                   |
| RRËNJA MERKLE | —                                                                                                                                                                  |
| ANKORIMI      | nuk është ankoruar ende<br><i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/47041f9d0824f697beb624f835c04da2fcea62d22f9833cc4c3f10e9bbad454a>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



1 e   [Republikanet mbyllin Konventen, Vance kandidat në 2028-en? FOUO: Bianca Censori habit me transformimin, flokë bionde dhe të brendshme të arta në pozat e reja! Po tralikohte 11 klandestine në fundit](#)

## Irani synon të kontrollojë kontaktet me të huajt, projektligji për “infiltrimin” nxjerr në pah përçarjet brenda establishmentit

11 Shtator 2026, 09:35Bota TEMA



Irani synon të kontrollojë kontaktet me të huajt, projektligji

Parlamenti i Iranit po përpiqet ta shndërrojë në ligj frikën nga infiltrimi i huaj. Por, derisa ligjvënësit po punojnë në këtë projektligj, debati po ngre një pyetje gjithnjë e më të sikletshme për Republikën Islamike: Sa larg mund të shkojë shteti në kontrollimin e kontakteve të iranianëve me botën e jashtme?

Në qendër të këtij debati është kryetari i Parlamentit, Mohammad Baqer Qalibaf, i cili, të paktën publikisht, po përpiqet të gjejë një baraspeshë. Ai e ka mbrojtur nevojën për masa më të ashpra kundër infiltrimit të huaj, ndërsa ka paralajmëruar se versioni i tanishëm i projektligjit shkon shumë larg.

“Patrioti nuk kundërshton luftën kundër infiltrimit të huaj”, tha Qalibaf gjatë një seance të fundit parlamentare. Por, ai shtoi se ligjvënësit duhet të sigurohen që “të drejtat, jeta dhe veprimtaria tregtare” e njerëzve të mos preken.

Ai tha se agjencitë e sigurisë mund të kenë nevojë të jenë në gjendje t’i verifikojnë kontaktet e iranianëve me të huajt, por se nuk mund të kërkojnë leje në çdo hap.

“Ata thonë se duan të jenë të sigurt, që leja të kërkohet prej tyre në çdo hap”, tha kryetari konservator i Parlamentit. “Kjo nuk është e mundur, sepse atëherë do të na duhej ta izoloni plotësisht vendin”.

Baraspesha është në thelb të këtij projektligji që u hartua si përgjigje në kohë lufte ndaj dështimeve të vërteta të sigurisë.

Dy luftërat e fundit zbuluan se sa thellë kishte depërtuar intelijenca izraelite në Iran dhe nxitën thirrje për masa më të ashpra për zbulimin dhe parandalimin e ndikimit të huaj.

Por, ajo që nisi si një përgjigje ndaj një çështjeje sigurie është shndërruar në një betejë shumë më të gjerë mbi kufijtë e sigurisë së shtetit të Republikës Islamike.

Projektligji, i quajtur zyrtarisht “Plani për Luftimin e Infiltrimit të Shërbimeve të Inteligjencës dhe Qeverive apo Institucioneve të Huaja”, por që zakonisht i referohen si “Projektligji për Infiltrimin”, do t’u kërkonte iranianëve të merrnin leje paraprake nga Ministria e Inteligjencës dhe Organizata e Inteligjencës së Gardës Revolucionare Islamike (IRGC), para se të angazhoheshin në një gamë të gjerë veprimtarish.

Këto veprimtari përfshijnë botimin e librave ose artikujve, bashkëpunimin akademik, intervistat me mediat e huaja që konsiderohen “armiqësore”, si dhe pjesëmarrjen në konferenca shkencore apo festivale të artit.

Projektligji përfshin gjithashtu dispozita që e bëjnë vepër penale dhënien e intervistave, zhvillimin e diskutimeve dhe komunikime të tjera me mediat që konsiderohen armiqësore, si dhe dërgimin e fotografive, videoeve, regjistrimeve audio apo materialeve të tjera te mediat e huaja.

Shkeljet do të dënoheshin me burgim deri në dy vjet.

Parlamenti miratoi kuadrin e përgjithshëm të projektligjit në mesin e gushtit, me 183 vota për dhe katër kundër. Që atëherë, projektligji është zgjeruar nga 19 në 33 nene, teksa ka kaluar në shqyrtim në Komisionin për Sigurinë Kombëtare dhe Politikën e Jashtme.

Deri tani, vetëm dy nenet e para janë miratuar në seancë plenare, ndërsa dispozitat e mbetura janë ende subjekt i ndryshimeve. Edhe nëse Parlamenti i miraton ato, projektligjin duhet ta miratojë Këshilli i Gardianëve në mënyrë që ai të mund të shndërrohet në ligj.

Megjithatë, rezistenca politike tashmë ka filluar.

Për shkak të paqartësive, Qalibaf i ka kthyer në komision dy nga dispozitat më të rëndësishme të projektligjit: nenet 7 dhe 8, të cilat lidhen me procesin e zbulimit të informacionit

ane aenimet per tejkaumin e kurtyve te nje tejeje.

Qalibaf ka këmbëngulur se Parlamenti duhet t'i adresojë shqetësimet e agjencive të sigurisë, duke thënë se “nevojat” e tyre do të përmbushen “brenda kufijve të arsyeshëm”.

Por, ai ka kundërshtuar idenë që Ministria e Inteligjencës dhe Organizata e Inteligjencës së Gardës Revolucionare Islamike të kenë në thelb kompetencën për të miratuar kontaktet e iranianëve me të huajt në çdo hap.

Ai gjithashtu ka hedhur poshtë sugjerimet se projektligji duhet të lihet mënjatë me kërkesë të Qeverisë.

Kur zëvendës-presidenti i parë, Mohammad Reza Aref, pretendoi se Qalibaf i kishte premtuar privatisht se do ta ndalte procesin e miratimit të projektligjit, një deputet e përsëriti këtë pretendim në seancë plenare. Qalibaf e hodhi poshtë atë, duke theksuar se Parlamenti nuk është “degë e Qeverisë”.

Rezultati është një vijë ndarëse politike që nuk përputhet lehtësisht me ndarjen e zakonshme në Iran mes vijës së ashpër dhe reformistëve.

Disa ligjvënës kanë qenë shumë më haptazi kundër projektligjit.

Mohammad Mehdi Shahriari, anëtar i Komisionit për Sigurinë Kombëtare dhe Politikën e Jashtme, e quajti atë “krejtësisht në kundërshtim me interesat kombëtare”.

Ai tha se projektligji ishte hartuar me shumë nxitim nga ligjvënës pa përvojë, dhe jo nga vetë strukturat e sigurisë së shtetit. Ai sugjeroi gjithashtu se bordi drejtues i Parlamentit, i kryesuar nga Qalibaf, tani ishte vetë “fuqishëm kundër” projektligjit.

Edhe qeveria e presidentit Masud Pezeshkian e ka kundërshtuar publikisht projektligjin.

Hossein Afshin, zëvendës-presidenti për shkencën, teknologjinë dhe ekonominë e bazuar në dije, paralajmëroi se versioni i tanishëm mund ta izolojë komunitetin akademik dhe kërkimor të Iranit dhe të çojë në “ngecje në shkencë”.

Komentatori konservator Mohammad Mohajeri, redaktor i Khabar Online, bëri një vërejtje të ngjashme, por në mënyrë më sarkastike. Ai shkroi në X se, pikërisht kur Qeveria po përpiqej t'i bindte iranianët që jetojnë jashtë vendit të ktheheshin në atdhe, Parlamenti po u jepte elitave, akademikëve dhe studentëve arsye të reja për t'u larguar.

Projektligji ka tërhequr gjithashtu kritika ndërkombëtare.

Më 3 shtator, Misioni Ndërkombëtar i Pavarur i Kombeve të Bashkuara për Gjetjen e Fakteve në Iran bëri thirrje që projektligji të tërhiqej, duke paralajmëruar se ai mund të kufizonte më tej liritë themelore dhe t'i izolonte iranianët nga komuniteti ndërkombëtar.

Raportuesja Speciale e OKB-së për Iranin, Mai Sato, paralajmëroi veçmas se agjencitë iraniane të inteligjencës nuk duhet të bëhen “rojet e portës” së kontakteve të popullit iranian me botën.

Për establishmentin politik të Iranit, megjithatë, problemi mund të jetë më pranë vendit.

Pak njerëz brenda sistemit duket se janë të gatshëm të kundërshtojnë faktin se infiltrimi i huaj është një kërcënim real për sigurinë. Debat i përqendrohet gjithnjë e më shumë te ajo që duhet të pasojë nga ky kërcënim dhe te vendi ku shteti duhet të vendosë kufirin./ [REL \(A2 Television\)](#)

## 1 Komente



Free Iran from islam

11 Shtator 2026, 12:01

Irani ka dhjetra vite (qe nga ardhja e islamisteve ne pushtet ne 1979), qe zyrtarisht dhe hapur fare i ka deklaruar lufte Izraelit. Zyrtarisht Irani ka kerkuar dhe kerkon ZHEDUKJEN e shtetit te Izraelit nga kjo bote! Ka dhjetra vite qe e kerkon dhe perpiqet ta beje kete. Te gjitha organizatat terroriste islamike rreth Izraelit dhe jo vetem, kane patur dhe kane mbeshtetjen e Iranit. Kete e thote dhe vete Irani, nuk ka ndonje dyshim per kete. “Vdekje Amerikes, Vdekje Izraelit” jane parrullat me te embla qe degjohen ne cdo tubim dhe organizim shteteror dhe shoqeror ne Iran, qe nga Ajatullahet ne qeveri e deri te hoxha katunar, me i fundit ne fund te cdo fshati. Keshtuqe te jeni te qarte : lufte ka vite qe e ka nisur Irani vete, pra lufta eshte ekzistente kunder Amerikes dhe kunder Izraelit. Izraeli kishte premtuar qe mashat nazi-islamiste ne rajon, qe mbeshteten nga Irani, do shkatetrohen plotesisht. S'ka me asnje shanc mbijetese per ta. Edhe vete Iranit drejperdrejt, do te ti thyehen brinjat deri atje, sa s'do marre me fryme dhe ne Iran ne pushtet do vijne forca te tjera politike! Dhe ashtu ka ndodhur tashme, Hamasi dhe Hezbollahu kane shkuar per lesh, ndersa ne qershor 2025 brenda 12 ditesh Izraeli e shkatetroi te gjithe sistemin berthamor te Iranit dhe te gjithe sistemin mbrojtës kunder-ajror te Iranit (kane sulmuar 100 avione izraelite, te cilet drejtoheshin qe te gjithë nga 100 pilote FEMRA). Qe atehere e sot Irani nga ajri eshte “pa breke ne bythe”, mund t'ja fuse Izraeli kur dhe ku te doje, ndersa Amerika mund te luaje si macja me miun per sport!!! Pas sulmeve te shkurtit 2026 ne Iran u shkaterrua plotesisht infrastruktura berthamore, po ashtu nuk ekziston fare marina ushtarake, u shkaterrua teresisht. Jane shkaterruar baza te rendesishme te Gardes Islamiste dhe objekte te Industrise Ushtarake dhe nderkohe jane eliminuar pafund udheheqes ushtarake dhe politiko-fetare te Iranit Islamist. Te jeni te sigurte, pushteti islamist ne Teheran i ka ditet e numeruara! Se shpejti Irani do CLIROHET dhe do futet ne rradhet e vendeve te civilizuar te botes, aty ku e meriton populli i lashte Pers! .

👤 [Përgjigjuni](#)

👍 0 🗳️ 0 ❤️ 0

🗨️ Lini një Përgjigje

Koment \*

Emër \*

POSTOJE KOMENTIN

[Putin mbërrin në New Delhi për samitin e BRICS, në fokus lufta në Ukrainë e Iran dhe tregtia globale](#)

09:15 Bota

[NATO ndjek anijet ruse në Arktik, dyshime për armë sekrete kundër kablllove nënujore](#)

09:05 Bota

[Spiunët, strategjitë dhe mundësitë e humbura, analiza: Si po nxirren ende mësimet e 11 shtatorit](#)

08:45 Bota

[“Dilni dhe votoni”/ Trump përsërit premtimin prej 5 mijë dollarësh për zgjedhjet e mesit të mandatit](#)

08:35 Bota / 3 komente

[11 Shtatori, 25 vjet nga sulmet terroriste në SHBA që ndryshuan botën](#)

08:05 Bota / 3 komente

[Alarm për kërcënim në konsullatën e Ukrainës në Dyseldorf, policia kontrollon ndërtesën](#)

07:54 Bota

[Shefi i NATO-s: Rusia është kërcënim afatgjatë, Evropa duhet të forcojë mbrojtjen](#)

07:47 Bota / 1 koment

[Tërmet i fortë në Liban, pasi Izraeli përdori mbi 1 mijë ton eksploziv për tunelet e Hezbollahut](#)

07:34 Bota / 1 koment

[Trump “korrigjon” veten: Lufta me Iranin mund të përfundojë para zgjedhjeve të mesmandatit](#)

22:55 Bota / 8 komente

Funerali shtetëror për Mladicin, Marta Kos: Serbia duhet të përballlet me të kaluarën! Raporti i shtatorit do të peshoië të ardhmen

## [e saj europiane](#)

22:45 Bota / 4 komente

## Më të lexuarat

24 oret e fundit

Javen e fundit

[“Berisha gënjeu demokratët” - Bejko: Nuk ka më të drejtën...](#)

09:45 Politika / 17 komente

[Plas në PD, Çim Peka sulmon Belind Këlliçin: Ky idioti po...](#)

15:45 Politika / 29 komente

[EKSKLUZIVE/ MUHAMED HALILI: Ju rrëfej “afërën e armëve” m...](#)

15:30 Dossier / 8 komente

[Gjyqtarët kallëzojnë në SPAK ministrin e Financave, reago...](#)

13:04 Politika / 51 komente

[‘Kallëzim se po zbatoj ligjin’, ministri Malaj publikon p...](#)

19:05 Politika / 77 komente

## Blog Tema

[Një telash më shumë për Partinë Demokratike](#)

19:10 Blog / 19 komente

[Kur protesta nuk shqetëson pushtetin, por merr peng qytetarin](#)

18:28 Blog / 33 komente

[Sikur Lana të mbyste bulevardin me baltë](#)

17:05 Blog / 8 komente

## Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Numri juaj i telefonit

Ju mund të ç'regjistroheni në çdo moment.

 Powered by Tomorrow.io

Tema është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, Tema është një nga gazetat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.



Built and Monetized by

- |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <ul style="list-style-type: none"><li>• <a href="#">Politika</a></li><li>• <a href="#">Kronika</a></li><li>• <a href="#">Editorial</a></li><li>• <a href="#">Blog</a></li><li>• <a href="#">Bota</a></li><li>• <a href="#">Sport</a></li><li>• <a href="#">Shëndeti</a></li><li>• <a href="#">Turizëm</a></li></ul> | <ul style="list-style-type: none"><li>• <a href="#">Sociale</a></li><li>• <a href="#">Ekonomia</a></li><li>• <a href="#">Antena</a></li><li>• <a href="#">Rajoni</a></li><li>• <a href="#">Kulturë</a></li><li>• <a href="#">Lifestyle</a></li><li>• <a href="#">Dossier</a></li><li>• <a href="#">Hi-Tech</a></li></ul> |
| <ul style="list-style-type: none"><li>• <a href="#">Kontakt</a></li><li>• <a href="#">Te dhënat personale</a></li><li>• <a href="#">Cookies</a></li></ul>                                                                                                                                                           |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |

Built and Monetized by



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.